



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

# RAPORTI VJETOR

## 2020

---

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP

Prishtinë, Mars 2021

Rruga Luan Haradinaj "Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati –I-, 10000 Prishtinë

[info@pzap-ks.org](mailto:info@pzap-ks.org), [www.pzap-ks.org](http://www.pzap-ks.org) 038/211-242



## **Përmbajtja**

LISTA E SHKURTESAVE.....	5
VIZIONI DHE MISIONI.....	6
Vizioni .....	6
Misioni .....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	6
Korniza Ligjore – Emërimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa .....	10
TAKIMET/MBLEDHJET E PZAP-IT .....	13
STRUKTURA.....	14
PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË PZAP-IT DHE PERSONELIT TË SEKRETARIATIT TË PZAP-IT, NË PUNËTORI DHE TRAJNIME TË NDRYSHME.....	15
PUNËTORITË E PZAP-it .....	15
TRAJNIMET E PZAP-it.....	15
AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË PZAP-it.....	16
MBLEDHJET E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT DHE ÇËSHTJET E PROPOZUARA PËR TU VENDOSUR NGA PZAP-I.....	16
DEPARTAMENTI LIGJOR.....	17
AKTIVITETET LIDHUR ME ÇËSHTJET E PERSONELIT TE SEKRETARIATIT TË PZAP-it ...	18
AKTIVITETET LIDHUR ME CERTIFIKIMIN E SHPENZIMEVE FINANCIARE PËR NEVOJA TË PZAP-it .....	20
AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR NEVOJA TË PZAP-it .....	21
BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME AKTERËT E TJERË TË ZGJEDHJEVE.....	21
TRYEZAT E ORGANIZUARA NGA INSTITUTI DEMOKRACIA PËR ZHVILLIM (D4D).....	24
Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) .....	24
Ankesat/Apelet e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës: .....	26
RAPORTI I BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE VJETORE PËR.....	27
VITIN FISKAL-2020 .....	27
BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE APROVUAR PËR VITIN – 2020 .....	28
BUXHETI I SHPENZUAR PËR VITIN 2020 .....	30
Paga dhe mëditjet.....	32
Mallra dhe shërbime .....	33
PJESA PËRMBYLLSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE.....	35

TË HYRAT E PZAP-it.....	35
TE HYRAT E REALIZUARA GJAT VITIT 2020.....	36
NJËSIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE LOGJISTIKËS .....	38
NJËSIA E PËRKTHIMEVE.....	39
NJËSIA E TRANSPORTIT.....	40

## **LISTA E SHKURTESAVE**

- PZAP** – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
- SPZAP** – Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
- KQZ** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- KGJK** – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- KPK** – Këshilli Prokurorial i Kosovës
- PK** – Policia e Kosovës
- MF** - Ministria e Financave
- MPB** – Ministria e Punëve të Brendshme – Administrata Publike
- OSBE** – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
- IFES** – Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore
- LZP** – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
- LZL** – Ligji për Zgjedhjet Lokale
- ZRPPC** - Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim
- SP**- Subjektet Politike
- KP** – Kandidat i Pavarur
- QNR** – Qendra për Numërimin e Rezultateve
- SIMFK** – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
- SIMBNJ** – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- SIMR** – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve
- NJQH** - Njësia Qendrore Harmonizuese
- ZAP** - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
- KRPP** – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- DASHC** – Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil

## **VIZIONI DHE MISIONI**

### **Vizioni**

PZAP-i është dhe synon të jetë një institucion i besueshëm, i qëndrueshëm, i fuqizuar dhe inovativ, që bashkëpunon për forcimin e drejtësisë zgjedhore.

### **Misioni**

PZAP-i me qëllim të fuqizimit të demokracisë, është i përkushtuar që me profesionalizëm, paanshmëri dhe me kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë akterët lidhur me procesin zgjedhor.

PZAP është i përkushtuar për përmbushjen me besnikëri të detyrave në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Të gjitha vendimet i merr në baza etike duke u bazuar në të gjitha provat për të promovuar besimin publik në aktivitetet e tij në përputhshmëri me ligjin, të pa ndikuara nga jashtë. Është i hapur dhe është përgjegjës për veprimtarinë që zhvillon si dhe siguron qasje për marrjen e informatave për të gjitha palët e interesuara.

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP-i, gjatë vitit 2020 ka kryer disa prej aktiviteteve të domosdoshme dhe të nevojshme të planifikuara me Planin Vjetor të punës për vitin 2020 e të cilat janë prezantuar në mënyrë të hollësishme në këtë raport vjetor. PZAP-i është dashur që t'i anuloi disa aktivitete të parapara për këtë vit për shkak të përhapjes së Pandemisë Covid-19 dhe masave të caktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.prot.01/07, të datës 11.03.2020, me qëllim të parandalimit të përhapjes së Pandemisë Covid-19. Në zbatim të këtyre masave, drejtuesit e PZAP-it kanë angazhuar stafin esencial për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës nga zyrat ndërsa një pjesë e punëve dhe detyrave të punës stafi i ka kryer nga distanca me internet, respektivisht ato punë dhe detyra të punës të cilat kanë qenë të mundura për tu kryer në këtë mënyrë.

Raporti vjetor i punës pasqyron aktivitetet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) gjatë vitit 2020, e në veçanti pasqyron punën dhe rezultatet e arritura të departamenteve dhe të njësisve tjera të administratës së sekretariatit, si dhe punën e panelit në përgatitjen dhe kryerjen e të

gjitha aktiviteteteve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe të Komunës e Mitrovicës së veriut. Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës në bazë të vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës fillimisht ishin caktuar të mbaheshin me datën 15 mars 2020. Mirëpo, për shkak të përhapjes së pandemisë Covid-19 dhe me qëllim të parandalimit të saj, mbajtja e zgjedhjeve në Komunën e Podujevës dhe Komunën e Mitrovicës së Veriut, me vendimet e Presidentit Nr. prot. 52/2020, të datës 14 mars 2020 dhe vendimin me Nr.prot.63/2020, të datës 11 qershor 2020, janë shtyrë për një afat të pacaktuar. Ndërsa me datë 20 tetor 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës, me vendimin Nr.prot.157/2020 dhe vendimin me Nr.prot.158/2020, vendosi që Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, të mbahen më datë 29 nëntor 2020.

Raporti përmban të dhëna statistikore përkitazi me numrin e ankesave dhe apeleve të pranuar e të vendosura gjatë vitit 2020, seancat e mbajtura, natyrën e ankesave, sanksionet e shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike, shpenzimet buxhetore, aktivitetet e prokurimit, numrin e përgjithshëm të punësuarve në PZAP. Raporti gjithashtu përmban të dhëna për pjesëmarrjen e anëtarëve të PZAP-it dhe stafit të sekretariatit në konferencat dhe punëtoritë e organizuara, të cilat për shkak të pandemisë disa ishin mbajtur përmes platformës elektronike Zoom dhe Skype bussines.

Të dhënat e paraqitura në raportin vjetor, janë dëshmi e punës së kryer me përkushtim dhe profesionalizmit nga ana e kryesueses-kryesuesit dhe anëtarëve të PZAP-it, stafit të administratës të sekretariatit që njëherësh do të jenë motiv shtesë për angazhim të mëtutjeshëm në tejkalimin e sfidave në proceset e ardhshme zgjedhore nga PZAP-i.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa punën e tij e ka përqendruar në drejtim të përmbushjes së objektivave të planifikuara me Planin Vjetor të Punës për vitin 2020 dhe të objektivave të planifikuara me Planin Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019, si dhe ka kryer punë dhe aktivitete të tjera të cilat nuk kanë qenë të planifikuara me Planin Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2020, siç ishin Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Podujevë dhe Mitrovicë e Veriut, të mbajtura më 29 nëntor 2020.

**Gjatë periudhës jo zgjedhore në vitin 2020, PZAP-i ka pranuar apelet: Anr. 35/2020, i datës 11.02.2020, Anr. 36/2020, i datës 11.02.2020, Anr.71/2020, i datës 22.10.2020 dhe Anr.72/2020, i datës 23.10.2020**

**Apeli: Anr. 35/2020, i datës 11.02.2020**

PZAP-i, me datën 11.02.2020 ka pranuar apelin Anr. 35/2020 nga Tinka Kurti, kandidate për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje! (LVV), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 102A-2020 , të datës 07.02.2020, për shkak të mos dërgimit të emrit të kandidates në fjalë nga KQZ-ja për tu dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës si deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi lejueshmërinë e paraqitjes së apelit, gjeti se, Apeli është i pabazuar, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues Nr.Prot. 102/A-2020 të KQZ-së të datës 07.02.2020 dhe kishte gjetur se i njëjti është në harmoni me dispozitën e nenit 112.2 pika a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku parashihet që një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1, zëvendësohet nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari.

**Apeli: Anr. 36/2020 i datës 11.02.2020**

PZAP-i, me datën 11.02.2020 ka pranuar apelin Anr. 36/2020 nga Drita Millaku, kandidate për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje! (LVV), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 102A-2020, të datës 07.02.2020, për shkak të mos dërgimit të emrit të kandidates në fjalë nga KQZ-ja për tu dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës si deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi lejueshmërinë e paraqitjes së apelit, gjeti se, Apeli është i pabazuar, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues Nr.Prot. 102/A-2020 të KQZ-së, të datës 07.02.2020, kishte gjetur se i njëjti është në harmoni me dispozitën e nenit 112.2 pika a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku parashihet që një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1, zëvendësohet nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madhtë votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari.



Ndërsa për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të komunave: Podujevë dhe Mitrovicë e Veriut, të mbajtura më 29 nëntor 2020, PZAP-i ka pranuar dhe vendosur për 1 (një) ankesë për Thyerjen e Heshtjes Zgjedhore, shkelje e cila kishte ndodhur në Mitrovicën e Veriut.

#### **Apeli:Anr.71/2020 i datës 22.10.2020**

PZAP-i me datë 22.10.2020, ka pranuar apelin e paraqitur nga subjekti politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi YTHP, ndaj vendimit të KQZ-së, me Nr.Prot.933/2020, i datës 21.10.2020, me të cilin është refuzuar kërkesa për regjistrimin e subjektit politik, në regjistrin e partive politike.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se KQZ me vendimin e lartcekur të kundërshtuar nga pala ankuese nuk kishte dhënë asnjë arsye ligjore mbi bazën e së cilës ishte refuzuar regjistrimi i subjektit politik në fjalë edhe përkundër faktit se subjekti i kishte plotësuar të gjitha kushtet ligjore për regjistrim dhe për këtë arsye e pranoi të bazuar apelin e subjektit politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi (YTHP), duke anuluar vendimin e KQZ-së, me Nr.Prot.933/2020 dhe çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim për ta vendosur KQZ-ja.

#### **Apeli:Anr.72/2020 i datës 23.10.2020**

PZAP-i, me datë 23.10.2020 ka pranuar apelin e paraqitur nga subjekti politik Partia Socialdemokrate e Kosovës (PSD), të paraqitur ndaj vendimit të KQZ-së, me Nr.Prot.935/2020, i datës 21.10.2020, për shkak të mos ndryshimit të llogos-shenjës të subjektit politik Partia Social Demokrate (PSD).

Gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës Paneli gjeti se subjekti politik PSD, nuk i kishte ndjekur procedurat e parapara ligjore për ndryshimin e llogos-shenjës të subjektit politik PSD dhe se të njëjtat nuk i kishte harmonizuar me statutin e subjektit të tyre politik, të cilat përcaktohen me nenin 7 të Statutit të Partisë.

Paneli, kishte vlerësuar se vendimi i KQZ-së, me Nr. 935-2020 të datës 21.10.2020, për refuzimin e kërkesës për mos ndryshimin e llogos-shenjës së subjektit politik PSD, ishte i drejtë dhe i ligjshëm duke u mbështetur në nenin 10.1 të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së Nr. 01/2013 dhe se për këtë arsye kishte refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit politik Partia Socialdemokrate e Kosovës (PSD).

## **Ankesa: Anr.1/2020 e datës 04.12.2020**

PZAP-i, me datë 04.12.2020, ka pranuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak se në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve në Mitrovicën e veriut, Kryetari i Listës Serbe dhe disa zyrtarë të kësaj liste si: Goran Rakiç dhe deputeti Igor Simic, në një prononcim për media kishin bërë ndërhyrje në procesin zgjedhor, duke bërë thirrje që të dalin masivisht në zgjedhje, të respektojnë masat për mbrojtje nga Covid-i dhe ta përkrahin kandidatin e Listës Serbe, pasi përkrahjen do ta kenë nga Shteti i Serbisë dhe presidenti Vucic, me ç ‘rast kishin bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës kishte vlerësuar se subjekti politik i lartpërmendur kishte bërë shkelje të Kodit Të Mirësjelljes Për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre Dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton *para procesit të votimit, ku përcaktohet se 24 orë, para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre dhe për këtë arsye kishte pranuar të bazuar ankesën e subjektit politik LVV dhe se Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, ishte gjobitur me 20,000.00 euro.*

Ndaj vendimit të PZAP-it, me numër Anr 1/2021 të datës 04.12.2020, subjekti politik Lista Serbe ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila me Aktvendimin e saj A.A13/2021, e datës 08.12.2020, ka refuzuar ankesën e Listës Serbe si të pabazuar, respektivisht ka vërtetuar vendimin e PZAP-it.

Të gjitha këto vendime të nxjerra nga PZAP-i, janë të publikuara në ueb faqen e PZAP-it, dhe në kopje fizike ju janë dorëzuar palëve.

## **Korniza Ligjore – Emërimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Ne bazë të nenit 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP-së, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Rregullat Zgjedhore.

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe emëron anëtarët nga mesi i gjykatësve të Gjykatës së Apelit dhe

Gjykatave Themelore të Kosovës që nënkupton së marrëdhënia e punës e anëtarëve të PZAP-it përfshi kryesuesin, funksionin në PZAP sipas LZP-së e kanë mandat shtesë.

Anëtarët dhe kryesuesi i PZAP-it kanë mandat katër (4) vjeçar.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia përbëhet nga dhjetë anëtarë përfshirë kryesuesen:**

1. Gyltene Sylejmani, Kryesuese e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës;
2. Fejzullah Rexhepi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtarë i Gjykatës se Apelit - Prishtinë;
3. Nenad Laziq, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit-Prishtinë;
4. Faton Ademi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Mitrovicë;
5. Afijete Sada, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Themelore-Gjakovë;
6. Zyhdi Haziri, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore-Gjilan;
7. Adnan Konushevc, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Prishtinë;
8. Rrustem Thaqi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit-Prishtinë
9. Kymete Kicaj, anëtare i PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Themelore-Prizren;
10. Ferki Xhaferi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore- Vushtrri.

Për shkak të përfundimit të mandatit katër vjeçar të kryesueses së PZAP-it Gyltene Sylejmani, dhe dy anëtarëve të PZAP-it, Fejzullah Rexhepi i cili ka dhënë dorëheqje pas emërimit të tij në pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Nenad Lazic, i cili ka përfunduar mandatin e dytë katër vjeçar si anëtar i PZAP-it, në kuptim të nenit 115.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të njëjtit janë zëvendësuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. GJ.A- S.U.A 211-2020, të datës 12.10.2020, në vend të kryesueses së PZAP-it Gyltene Sylejmani, kryesues i PZAP-it është emëruar Shukri Sylejmani, Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. GJ.A- S.U.A 214/2020, të datës 14.10.2020, në vend të anëtarit të PZAP-it Fejzullah Rexhepi, anëtarë i PZAP-it është emëruar Burim Ademi, Gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. GJ.A- S.U.A 244/2020, të datës 08.11.2020, në vend të anëtarit të PZAP-it Nenad Lazic, anëtare e PZAP-it është emëruar Milena Deriq, Gjyqtare e Gjykatës së Apelit në Prishtinë.



Shukri Sylejmani,  
kryesues



Afijete Sada-Gillogjani,  
anëtare



Zyhdi Haziri,  
anëtar



Faton Ademi,  
anëtar



Adnan Konushevc,  
anëtar



Rrustem Thaqi,  
anëtar



Kymete Kicaj,  
anëtare



Ferki Xhaferi,  
anëtar



Milena Deric,  
anëtare



Burim Ademi,  
anëtar

## **TAKIMET/MBLEDHJET E PZAP-IT**

PZAP-i gjatë vitit 2020 ka mbajtur shtatë (7) takime/mbledhje të rregullta mujore në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë marrë disa vendime që kanë të bëjnë me çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it, duke përfshirë këtu edhe vendimet e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës dhe Komunës së Mitrovicës së Veriut, të mbajtura me datën 29 nëntor 2020.

Vendimet më kryesore ishin:

- Vendimi për miratimin e Raportit Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2019,
- Vendimi për miratimin e Raportit 6 (Gjashtë) mujor të punës së PZAP-it për vitin 2020,
- Vendimi për miratimin e Planit të Punës së PZAP-it, për vitin 2020,
- Vendimi për miratimin e Planit të Veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës, të caktuara që të mbahen më 15 Mars 2020,
- Vendimi për Zgjatjen e Orarit të Punës për stafin e sekretariatit të PZAP-it për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës, të caktuara që të mbahen më 15 mars 2020,
- Vendimi për pagesën e shtesave për angazhime shtesë gjatë dhe pas orarit të punës për anëtarët e PZAP-it, përfshirë kryesuesin e PZAP-it, si dhe të zyrtarëve të sekretariatit të PZAP-it për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës, të caktuara që të mbahen më 15 mars 2020,
- Vendimi për miratimin e Planit të Veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar të komunave: Podujevë dhe Mitrovicë e Veriut, të mbajtura më 29 Nëntor 2020,
- Vendimi për pagesën e shtesave për angazhime shtesë gjatë dhe pas orarit të punës për anëtarët e PZAP-it, përfshirë kryesuesin e PZAP-it si dhe të zyrtarëve të sekretariatit të PZAP-it për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave të Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, të mbajtura më 29 Nëntor 2020,
- Vendimi për Zgjatjen e Orarit të Punës për stafin e sekretariatit të PZAP-it për Zgjedhjet për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të komunave Podujevë dhe Mitrovicë e Veriut, të mbajtura më 29 Nëntor 2020,

- Vendimi për plotësim dhe ndryshim të vendimit të komisionit të përhershëm për çështje ligjore,
- Vendimi për hartimin e Planit Strategjik të PZAP-it, për periudhën 2021-2024, etj.


## **STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT**

Struktura organizative e Institucionit të PZAP-it, përbëhet nga anëtarët e PZAP-it përfshirë kryesuesin, si trup vendimmarrës profesional, dhe nga Sekretariati i tij i cili mbështetë punën e PZAP-it në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me LZP.

Me buxhetin e propozuar për vitin 2020 dhe i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i ka të lejuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtar të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të sekretariatit të PZAP-it.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të PZAP-it, përfshirë kryesuesin është dhjetë (10), prej tyre shtatë (7) janë të gjinisë mashkullore ose 70% ndërsa tre (3) janë të gjinisë femërore ose 30%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale nëntë (9) janë shqiptarë ose 90% ndërsa një (1) anëtarë është i përkatësisë serbe, ose 10%.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Sekretariatit e PZAP-it është 9 veta, prej tyre pesë (5) janë të gjinisë mashkullore ose 55% ndërsa 4 janë të gjinisë femërore ose 45%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale tetë (8) janë shqiptarë ose 89% ndërsa një (1) i punësuar është i përkatësisë boshnjake, ose 11%.



## **PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË PZAP-IT DHE PERSONELIT TË SEKRETARIATIT TË PZAP-IT, NË PUNËTORI DHE TRAJNIME TË NDRYSHME**

### **PUNËTORITË E PZAP-it**

Në Planin Vjetor të punës për vitin 2020, PZAP-i, ka paraparë organizimin e punëtorive dhe vizita jashtë vendit për anëtarët dhe zyrtarët e PZAP-it, por të cilat nuk janë realizuar për shkak të përhapjes së pandemisë Covid-19, si dhe të shpalljes dhe të organizimit të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe të Mitrovicës së Veriut.

### **TRAJNIMET E PZAP-it**

Personeli i Sekretariatit, gjatë muajit shkurt të vitit 2020, ka marrë pjesë në trajnimin me temën: Parimi i rekrutimit të bazuar në meritë, i mbajtur më 13 Shkurt 2020 në Prishtinë, i organizuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, ndërsa për shkak të përhapjes së pandemisë Covid-19, zyrtarët e Sekretariatit kanë marrë pjesë në trajnime online përmes platformës Zoom dhe Skype bussines, të organizuara nga Instituti i Administratës Publike (IKAP), lidhur me temat si në vijim:

- Hartimi i koncept dokumenteve dhe teknikat e legjislacionit, të mbajtur me datë 12,13 Tetor 2020;
- Përpilimi i shkresave formale/joformale në Administratën Publike, të mbajtur me datë 9, 10 Nëntor 2020;
- Sfidat e zhvillimit të drejtave të njeriut në botën bashkëkohorë, të mbajtur me datën 12, 13 Nëntor 2020;
- Lidërshipi dhe menaxhimi në Administratë Publike, të mbajtur me datë 8, 9, 10 Dhjetor 2020,
- Procesi dhe teknikat për komunikimin me publikun lidhur me zbatimin e detyrimeve nga MSA, të mbajtur me datë 22, 23 Shtator 2020;
- Hulumtime shkencore dhe analiza e të dhënave me Statistical Package for the Social Sciences (SPSS), të mbajtur me datë 8, 9, 12 dhe 19 Tetor 2020;

- Planifikimi, menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, të mbajtur me datë 19, 20 Nëntor 2020;
- Administrimi i punës në zyrë, të mbajtur me datë 7, 8 Dhjetor 2020;
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore.

## **AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË PZAP-it**

### **MBLEDHJET E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT DHE ÇËSHTJET E PROPOZUARA PËR TU VENDOSUR NGA PZAP-I**

Gjatë vitit 2020, Sekretariati i PZAP-it ka mbajtur shtatë (7) takime të rregullta, të cilat takime si zakonisht i kanë paraprirë mbajtjes së takimeve të rregullta të PZAP-it.

Në këto takime të mbajtura janë shqyrtuar dhe diskutuar çështje të ndryshme si: përgatitja dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara të PZAP-it dhe sekretariatit, shqyrtimi dhe diskutimi i detyrave për vitin 2020, përgatitja e Draft Raportit të punës së PZAP-it për vitin 2019, Planit Strategjik për periudhën 2021-2023, Nxjerrja e Rregullores së Punës së PZAP-it, Përgatitjet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe të Mitrovicës së Veriut të cilat ishin të caktuara të mbahen më 15 mars 2020, të cilat zgjedhje për shkak të rrethanave të krijuara nga Pandemia Covid-19 janë shtyrë dhe janë mbajtur me datën 29 Nëntor 2020, shqyrtimi dhe diskutimi lidhur me aktivitetet tre mujore të punës së PZAP-it si dhe diskutimi lidhur me realizimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2020 si dhe përgatitja e Planit të Punës për vitin 2021. Pastaj janë diskutuar çështjet e personelit të sekretariatit, çështje të prokurimit, çështje të buxhetit dhe financave, çështje të teknologjisë informative dhe logjistike, përkthimin e dokumenteve të PZAP-it çështje të transportit etj.

Personeli i sekretariatit të PZAP-it, për të gjitha takimet e rregullta të mbajtura nga ana e panelit të PZAP-it ka përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për mbajtjen e tyre, edhe atë si: dërgimi i ftesave anëtarëve të PZAP-it dhe agjendës me pikat e rendit të ditës, dërgimi i procesverbaleve anëtarëve të PZAP-it për mbledhjet e mbajtura, pastaj ka bërë përgatitjen e propozim-vendimeve për aprovim në takimet e mbajtura nga PZAP-i për çështjet e ndryshme për vitin 2020.

Gjithashtu kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it në përputhje me mandatin e përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjet tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës ka nxjerr vendime për çështjet si në vijim:



- Vendimi për caktimin e U.D. të Drejtorit të Departamentit Ligjor të SPZAP-it, për shkak të mbetjes së kësaj pozite vakante.
- Vendimi për caktimin e U.D. Zyrtare e Lartë Ligjore, në zëvendësim të Zyrtarit të Lartë Ligjor,
- Vendimet për aprovimin e një pagese shtesë në emër të shpërblimit të përvjetorit jubile (10 vjetorit të punës) për Zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-it,
- Vendim për aprovimin e një ore në ditë pushim me pagesë për Zyrtaren e Lartë Ligjore për shkak të kujdesit ndaj fmiut.
- Vendimi për shfuqizimin e vendimeve për U.D. të Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe e U.D. Zyrtares së Lartë Ligjore.
- Kërkesa për alokimin e mjeteve financiare për blerjen e maskave mbrojtëse dhe dezinfektuesve kundër Covid 19.
- Vendimi për emërimin e Komisionit për vlerësimin e pasurisë jo financiare.
- Vendimi për emërimin e Komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare
- Vendimi për emërimin e Komisionit për tjetërsimin e pasurisë jo financiare, etj.

## **DEPARTAMENTI LIGJOR**

Aktivitetet e Departamentit Ligjor kanë qenë si në vijim:

- Zyrtarët e departamentit ligjor kanë marrë pjesë në të gjitha takimet e Sekretariatit të PZAP-it, gjatë vitit 2020;
- Në bashkëpunim dhe koordinim me kryesuesin e sekretariatit kanë përgatitur draft agjendën për takimet e PZAP-it, dhe njoftimin e kryesueses/kryesuesit si dhe anëtarëve të PZAP-it për mbajtjen e takimeve të PZAP-it.
- Pjesëmarrja e zyrtarëve të lartë ligjor në takimet e PZAP-it në cilësinë e procesmbajtësit të takimeve dhe njoftimi i anëtarëve dhe kryesueses së PZAP-it me procesverbalet e takimeve të mbajtura.
- Përgatitja e të gjitha materialeve fizike për takimet e PZAP-it.
- Përgatitja e Planit të Punës së Departamentit Ligjor për vitin 2020.
- Përgatitja e Planeve Individual të Punës së Zyrtarëve të Departamentit Ligjor për vitin 2020.
- Zyrtarët e Departamentit Ligjor kanë përgatitur të gjitha paralajmërimet për subjektet politike për ti paguar gjobat e shqiptuara nga PZAP-i ndaj tyre gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019.

- Takimet e mbajtura nga zyrtarët e Departamentit ligjor lidhur me ndarjen e detyrave për hartimin dhe përgatitjen e Rregullores së Punës së PZAP-it, Raportit Vjetor të punës së PZAP-it për vitin 2019 si dhe Raportet tre mujore të punës së PZAP-it për vitin 2020.
- Pjesëmarrja e zyrtarëve të Departamentit ligjor në mbledhjet e PZAP-it lidhur me përgatitjen për procesin Zgjedhor për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut.
- Përgatitja e kërkesave për përgjigje në ankesa dhe shkresave tjera të nevojshme lidhur me ankesat dhe apelet, përgatitja e draft vendimeve, procedimi i vendimeve tek palët, për procesin zgjedhor për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, si dhe menaxhimi i ankesave jashtë procesit zgjedhor.
- Shkëmbimi i informacioneve në mes të Departamentit ligjor të SPZAP-it me zyrtarët e Sekretariatit të KQZ dhe ZRPPC-së lidhur me kërkesat e ndryshme për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut si dhe kërkesat dhe informatat e ndryshme për subjektet politike që janë në procedurë të përmbarimit të vendimeve të PZAP-it.
- Përgatitja e materialit në kopje fizike të rasteve-ankesave që kanë të bëjnë me elemente të veprave penale, për dërgim në Prokurorinë e Shtetit.
- Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike për vitin 2019.
- Përgatitja e raporteve të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2020.
- Zyrtarët e Departamentit Ligjor në kuadër të aktiviteteve të tyre si punë shtesë të caktuara nga Kryesuesi i Sekretariatit kanë kryer edhe detyra tjera si në vijim:

Çështje të Personelit, Certifikimit të Shpenzimeve të PZAP-it, dhe Çështje të Prokurimit:

### **AKTIVITETET LIDHUR ME ÇËSHTJET E PERSONELIT TE SEKRETARIATIT TË PZAP-it**

- Përditësimi i të dhënave të nëpunësve civil dhe anëtarëve të PZAP-it në dosjet e tyre personale në mënyrë fizike dhe elektronike përmes Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ),

- Përgatitja dhe plotësimi i formularit të përgjithshëm të vlerësimit të performancës për personelin e Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (SPZAP-it),
- Përgatitja e planit vjetor të trajnimit për nëpunësit civil të SPZAP-it, dhe dorëzimi sipas kërkesës në DASHC/MAP,
- Përgatitja e kërkesave për pagesën e pagës jubilarë të zyrtarëve të SPZAP, për qasje në sistem për listë të pagave, dhe përgatitja e dokumenteve përcjellëse,
- Dërgimi i Draft Planit të personelit të SPZAP-it në SIMBNJ dhe dërgimi i tij për aprovim në MAP,
- Evidenca e përvojës së punës për personelin e SPZAP-it, llogaritja deri në periudhën 31 dhjetor 2019,
- Kërkesa për planifikim të pushimeve vjetore dërguar personelit të SPZAP-it, për vitin 2020,
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga DASHC/MAP me temën Menaxhimi i burimeve njerëzore,
- Plotësimi i të dhënave statistikore për nëpunësit civil të SPZAP-it, për vitin 2019 në SIMBNJ (Raportimi vjetor),
- Planifikimi i pushimit vjetor (Plani orientues i pushimeve për vitin 2020) në SIMBNJ, për nëpunësit civil të SPZAP-it,
- Kërkesë për aprovimin e qasjes për shkarkimin e listës së pagave për institucionin e PZAP-it,
- Plotësimi i pyetësorit të dërguar, nga DASHC/MAP, Etike Korrupsion,
- Përgatitja dhe menaxhimi i orarit të kujdestarisë për muajin Shkurt dhe Mars 2020 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës, në mënyrë fizike,
- Përgatitja dhe dorëzimi i listës së zyrtarëve të lartë publik të PZAP-it, dhe dërgimi në AKK,
- Njoftimi në Agjencinë Kundër Korrupsion - AKK për emërimin e Ushtruesit të Drejtorit të Departamentit Ligjor PZAP,
- Pjesëmarrje njëditore në Trajnimin me temën: Rekrutimet e bazuara në meritë dhe shkathhtësitë e intervistimit, 13.02.2020, projekt i Ambasadës Britanike,
- Përgatitja e shkresave si vërtetime për pushim dhe marrëdhënie të punës sipas kërkesës së zyrtares së lartë ligjore,
- Njoftimi me ftesat për trajnim udhëheqësit e Departamenteve,
- Njoftim i zyrtarëve të lartë publik lidhur me deklarinimin e pasurisë në bazë të kërkesës nga AKK, me datë 02.03.2020,
- Njoftim i AKK lidhur me regjistrin e dhuratave në PZAP për vitin 2019,

- Përgatitja e dokumenteve sipas kërkesës së auditorit për vitin 2019, si plotësimi i listës me të dhëna të nëpunësve të PZAP-it, ndërprerje e kontratës së punës për ish drejtorin e Departamentit Ligjor, Formularë të vlerësimit, Vendim për ushtrues detyre të ZL, Procedura e rekrutimit për Zyrtarët Jo permanent për Zgjedhjet e 6 tetorit 2019, më datë 02.03.2020,
- Përgatitja e vendimeve për pesë zyrtar të SPZAP-it, lidhur me pagesën e pagës jubilarë,
- Përgatitja e dokumenteve dhe nxjerrja e orëve shtesë për muajin Mars 2020 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës të planifikuara që të mbahen me datën 15 mars 2020, po ashtu janë dorëzuar në MAP në mënyrë elektronike,
- Shkarkimi përmes sistemit të listës së pagave për periudhën shkurt-dhjetor 2020,
- Përgatitja e kërkesave për pushimet vjetore për personelin e SPZAP-it në mënyrë fizike dhe përmes SMBNJ.
- Njoftimi në Agjencinë Kundër Korrupsion - AKK për përfundimin e mandatit të Ushtruesit të Drejtorit të Departamentit Ligjor PZAP,
- Menaxhimi i sistemit të vijueshmërisë SMVP, në mënyrë elektronike dhe fizike, për periudhën Janar-Dhjetor 2020,
- Menaxhimi i orarit të punës gjatë kohës së pandemisë Covid - 19 për periudhën korrik-shtator 2020,
- Menaxhimi i ftesave dhe konfirmimet e tyre në IKAP për pjesëmarrjen e personelit në trajnimet sipas planit kalendarik të IKAP-it, për periudhën korrik-shtator 2020,
- Plotësimi i pyetësorëve të IKAP-it në lidhje me pajisjet elektronike për mbajtjen e trajnimeve online.

## **AKTIVITETET LIDHUR ME CERTIFIKIMIN E SHPENZIMEVE FINANCIARE PËR NEVOJA TË PZAP-it**

- Aprovimi i shpenzimeve të realizuara për të gjitha kontratat e lidhura me operatorët ekonomik (shpenzimet e telefonisë fikse, telefonisë mobile, për ujë të pijshëm, për karburante të veturave të PZAP-it, pastrimin e veturave të PZAP-it, TV kabllor dhe internet, shpenzimet për shfrytëzimin e fotokopjeve dhe printerëve me qera) etj.
- Aprovimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për përmbarimin e vendimeve me titull ekzekutiv.
- Aprovimi i shpenzimeve të realizuara për blerjen e pajisjeve të TI-kompjuterëve për PZAP-in, si dhe për mirëmbajtjen e TI-serverit,
- Aprovimi i shpenzimeve për regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve zyrtare të PZAP-it,

- Aprovimi i shpenzimeve për takimet e fund vitit lidhur me përfundimin e mandatit të ish kryesueses dhe anëtarëve të PZAP-it,
- Aprovimi i shpenzimeve për blerjen e materialit të nevojshëm për personelin e PZAP-it, maskave mbrojtëse dhe dezinfektuesve për mbrojtje nga Covid -19,
- Aprovimi i shpenzimeve për blerjen dhe furnizimin me material administrativ për PZAP,
- Mbyllja e avansit për para të imta - kthimi i mjeteve,
- Mbyllja e petty- cashit për shpenzimet e realizuara,
- Aprovimi i shpenzimeve tjera varësisht nga nevojat e PZAP-it.

### **AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR NEVOJA TË PZAP-it**

- Përgatitja e Planifikimit Paraprak të Prokurimit Publik për institucionin e PZAP-it,
- Publikimi në mënyrë elektronike të Planit Final të Prokurimit Publik për vitin 2020 tek faqja zyrtare e E-prokurimi-t.
- Përgatitja e raportit për kontratat e nënshkruara të PZAP-it për vitin 2019 dhe dorëzimi në Komisionin Rregullativ të Prokurimit (KRPP),
- Gjatë periudhës kohore Janar-Qershor 2020 institucioni i PZAP-it nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet të prokurimit publik, për shkak të pandemisë Covid-19, vetëm se i ka bërë urdhër blerjet për të gjitha kontratat e plotfuqishme me Operatoret Ekonomik,
- Zbatimi i Planifikimit final të Prokurimit Publik për institucionin e PZAP-it,
- Gjatë periudhës kohore Korrik-Shtator 2020 institucioni i PZAP-it ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik Kuotimi i çmimit me vlerë minimale, për regjistrimin e automjeteve zyrtare të PZAP-it,
- Zhvillimi i procedurës së prokurimit Kuotimi i çmimit me vlerë minimale, për lidhjen e kontratës furnizim me material administrativ për institucionin e PZAP-it,
- Realizimi i urdhër blerjeve për të gjitha kontratat e plotfuqishme me Operatoret Ekonomik,
- Njoftimi i operatoreve ekonomik me menaxheret e kontratave sipas kërkesës së Agjencisë Qendrore të Prokurimit-AQP-së, lidhur me kontratat të cilat janë të lidhura në nivel qendror.

### **BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME AKTERËT E TJERË TË ZGJEDHJEVE**

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2016, në mes të akterëve të zgjedhjeve, PZAP-it, KQZ-së, Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të

Kosovës, PZAP ka implementuar të gjitha obligimet e parapara me këtë Memorandum. Niveli i bashkëpunimit me akterët e këtij memorandumi është ngritur në veçanti pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, të cilat kanë qenë të planifikuara që të mbahen me datën 15 mars 2020.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mes të akterëve të zgjedhjeve nënshkruese të Memorandumit janë mbajtur 3 takime lidhur me koordinimin e aktiviteteve të të gjitha institucioneve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës në Podujevës.

**Takimi i parë** është mbajtur me datë 19.02.2020, në zyrat e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së), në të cilin takim është diskutuar lidhur me Planin Operacional të Sigurisë për Zgjedhje.

**Takimi i dytë** është mbajtur me datë 3 mars 2020, në Kuvendin Komunal të Podujevës, në të cilin takim është diskutuar Programi Orientues i Sigurisë për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, me të gjithë Menaxherët e Qendrave të Votimit, respektivisht me drejtorët e Shkollave të Komunës së Podujevës si dhe me udhëheqësit e Policisë Regjionale të Komunës së Prishtinës dhe të Komunës së Podujevës, përgjegjës për mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

**Takimi i tretë** është mbajtur me datë 12.03.2020, në zyrat e KQZ-së. Në këtë takim të sigurisë është diskutuar dhe janë shkëmbyer informatat lidhur me koordinimin e aktiviteteve për përmbylljen e fushatës zgjedhore, shpërndarjen e materialit sensitiv (fletëvotimet) dhe materialet tjera përcjellëse sensitive dhe për administrimin dhe menaxhimin e situatave për ditën e zgjedhjeve. Përveç këtyre takimeve dhe aktiviteteve në mes të PZAP-it dhe KQZ-së ka pasur shkëmbim të informatave lidhur me Listën e Qendrave të Votimit dhe Listën e Ekipeve Mobile për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë për verifikim në PZAP, lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike, pastaj me emrat e personave të ndaluar me vendime të PZAP-it, për pjesëmarrje në zgjedhje, si dhe lidhur me ruajtjen e materialit zgjedhor për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019, që janë objekt hetimi nga Prokuroria e Shtetit.

Në takimet e rregullta zyrtarët përgjegjës të këtyre institucioneve kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në Podujevë, deri me datën 14 mars 2020, ku për shkak të sëmundjes Covid – 19, Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës nuk janë mbajtur ashtu siç kanë qenë të caktuara të mbahen me datën 15 mars 2020, të cilat janë shtyrë për një datë të pacaktuar.

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit për procesin zgjedhor ndërmjet: (KQZ, PZAP, PSH, PK dhe KGJK), KQZ me datën 09.01.2020, ka organizuar takimin në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e këtyre institucioneve. Në takim është diskutuar lidhur me “Kutitë e votimit që ruhen nga KQZ-ja nga viti 2007, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2017 dhe 2019, si objekt hetimi për Prokurorin e Shtetit dhe Gjykatat”.

Në pajtim me Kodin Penal të Kosovës, Kapitulli X, nenin 99, KQZ-ja, ka dërguar listën e vendvotimeve nga zgjedhjet e vitit 2007 dhe 2009, të ruajtura nga KQZ-ja me kërkesën e organeve të Drejtësisë, të cilat tashmë kanë pushuar hetimet si rezultat i parashkrimit absolut të këtyre lëndëve penale.

Sipas legjislacionit në fuqi këto lëndë (materialet e votimit në kutitë e votimit, respektivisht të vendvotimeve) kanë arritur afatin e parashkrimit dhe të njëjtat nuk kanë më efekt juridik për provë në procedurën penale. Andaj, sipas procedurave të brendshme, në fillim të muajit korrik 2020, KQZ të gjitha ato materiale do t'i shkatërroj, me qëllim të lirimit të hapësirave të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve.

PZAP-i sa i përket obligimeve ligjore lidhur me këtë çështje me kohë ka informuar KQZ-në, si në vijim:

PZAP-i për zgjedhjet e vitit 2007 nuk ka poseduar asnjë informate lidhur me materialet e kutive të votimit për arsye se në atë kohë për ato zgjedhje, procesin e zgjidhjes së kontesteve zgjedhore e ka kryer Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa i cili ka qenë nën ombrellën e UNMIK-ut dhe OSBE-se, që do të thotë se, PZAP-i nuk ka trashëguar asnjë nga evidencat e materialeve të procesit zgjedhor, respektivisht të vendvotimeve.

Ndërsa, sa i përket Zgjedhjeve Lokale të vitit 2009, PZAP-i, ish KZAP ka dërguar në adresë të Prokurorisë së Shtetit, listën me evidencën e lëndëve të cilat kanë pas element të veprave penale, por që lidhur me këto evidenca nuk ka pranuar informata kthyesë se si janë vendosur këto lëndë as nga Prokuroria e Shtetit e as nga Gjykatat.

Për shkak se PZAP-i nuk ka pranuar asnjë informatë kthyesë nga institucionet kompetente për këto raste është në kompetencë të Këshillit Prokurorial të Kosovës- KPK-së dhe Këshillit Gjyqësorë të Kosovës - KGJK-s, që të vendosin lidhur me parashkrimin apo jo të këtyre lëndëve, në mënyrë që KQZ-ja të mund të ndërmarr veprime për ruajtjen apo shkatërrimin e materialeve të Vendvotimeve.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mes të akterëve të zgjedhjeve nënshkruese të Memorandumit janë mbajtur 2 takime lidhur me koordinimin e aktiviteteve të gjitha institucioneve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut .

**Takimi i parë** është mbajtur me datë 10.11.2020, në zyrat e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së), në të cilin takim është diskutuar lidhur me Rekomandimet IKSHP-së, për procesin Zgjedhor në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut për parandalimin e virusit COVID-19 gjatë procesit zgjedhor.

**Takimi i dytë** është mbajtur me datë 24.11.2020, në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së.) e cila ka të bëjë me Takimin e Sigurisë për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut, të datës 29.11.2020. Në këtë takim të sigurisë është diskutuar lidhur me fazën finale të përgatitjeve për procesin zgjedhor.

Përveç këtyre takimeve dhe aktiviteteve në mes të PZAP-it dhe KQZ-së ka pasur shkëmbim të informatave të ndryshme gjatë tërë procesit zgjedhor, po ashtu ka bërë verifikimin e propozimeve të Këshillave të Vendotimeve (KVV-ve), për Komunën e Podujevës, nëse me vendime të PZAP-it janë ndaluar për të qenë pjesë e administratës së zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja.

## **TRYEZAT E ORGANIZUARA NGA INSTITUTI DEMOKRACIA PËR ZHVILLIM (D4D)**

### **Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D)**

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D), ka organizuar dy takime jo formale me akterët e Memorandumit të Bashkëpunimit për zgjedhje në Kosovë, një me datën 22.01.2020 dhe një me datën 17.06.2020, në të cilat është diskutuar rreth përfshirjes së Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në Memorandumin e Bashkëpunimit për procesin zgjedhor dhe të jetë pjesë në udhëzuesin për zgjedhje bashkë me akterët tjerë të zgjedhjeve. Përveç këtyre takimeve për shkak të virusit Covid-19, në mes të Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) dhe akterëve të Memorandumit të zgjedhjeve janë shkëmbyer edhe informata zyrtare përmes email-it lidhur me përfshirjen e Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), që të jetë pjesë e Memorandumit të Bashkëpunimit për procesin zgjedhor.

Me datën 30.09.2020, Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D), ka organizuar takim solemn me akterët e zgjedhjeve, përfshi Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), në të cilin takim është bërë nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit nga përfaqësuesit e institucioneve të lartë theksuara.



Në këtë takim solemn institucionin e PZAP-it e kanë përfaqësuar kryesuesja e PZAP-it, Gyltene Sylejmani dhe kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it Mulë Desku.

### **Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka njoftuar PZAP-in me kërkesën e parashtruar në këtë Gjykatë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), si dhe me Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë rast**

PZAP-i, është njoftuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës për kërkesën me numër prot. KI27/20, të datës 20 shkurt 2020, e parashtruar në këtë Gjykatë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019, që të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 16/2019 të datës 10.10.2019, dhe Vendimit të PZAP-it, Anr.233/2019 të datës 06.10.2019, lidhur me publikimin e një video spoti në objektin publik të Policisë së Kosovës.

Në këtë rast Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin me Nr.ref.:1616/20 të datës 07 Shtator 2020 ka vendosur për rastin me nr. KI27/20 të datës 07.09.2020, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AA-UZ nr. 16/2019 të datës 10.10.2019, si dhe Vendimit të PZAP-it, Anr.233/2019 të datës 06.10.2019, e në të cilin Aktgjykim, theksohet se vendimet në fjalë janë të ligjshme, dhe se nuk ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

### **Përmbledhje e informatave dhe të dhëna statistikore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe në Mitrovicën e Veriut.**

Pas anulimit të vendimit për mbajtjen e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujeve dhe në Mitrovicën e Veriut për shkak të pandemisë COVID 19, presidenti i Republikës së Kosovës me vendimin me numër protokoli 157-2020 dhe 158-2020 të datës 20.10.2020, caktoi që Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut të mbahen më 29.11.2020. Sipas vendimeve organizimi dhe mbajtja e Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovica e Veriut është bërë në koordinim dhe bashkërendim me institucionet përkatëse në pajtim me ligjin Nr.07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, në territorin e Republikës së Kosovës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) në bazë të Planit të Veprimit, ka përfunduar të gjitha aktivitetet për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, të cilat janë mbajtur më datë 29.11.2020.

Prej shpalljes së zgjedhjeve me datën 20 tetor 2020, deri në certifikimin e rezultateve në këto dy komuna, respektivisht deri me përfundimin e afatit për paraqitjen ankesave dhe apeleve për të gjitha fazat e procesit zgjedhor, të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe Mitrovicën e Veriut të mbajtura me 29 Nëntor 2020, në PZAP është parashtruar vetëm një ankesë e cila është shqyrtuar dhe vendosur nga PZAP-i brenda afatit ligjor.

Ankesa është parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje kundër Listës Serbe për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore dhe i takon periudhës së ditës së heshtjes zgjedhore.

### **Ankesat/Apelet e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës:**

Gjatë Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut të mbajtura me 29 Nëntor 2020 dhe jashtë procesit zgjedhor, palët e pa kënaqura me vendimet e PZAP-it, kanë ushtruar të drejtën e tyre ligjore duke i kundërshtuar ato në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Në Gjykatën Supreme të Kosovës janë paraqitur 4 ankesa kundër vendimeve të PZAP-it, dhe katër ankesat e paraqitura janë refuzuar.

Natyrat e vendimeve të PZAP-it, të cilat janë ankimuar nga palët në Gjykatën Supreme të Kosovës, janë si në vijim:

- Për shkak të gjobës së shqiptuar në vlerë prej 20,000.00 euro, për thyerjen e heshtjes zgjedhore në ditën e votimit në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut;
- Për shkak të mos dërgimit të emrit të dy kandidatëve për deputete të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje! Tinka Kurti dhe Drita Millaku nga KQZ-ja për tu dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës si deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Për shkak të mos ndryshimit të logos-shenjës së subjektit politik Partia Social Demokrate (PSD);

Me poshtë gjeni listën me rastet e Apeluara në Gjykatën Supreme të Kosovës:

1. Vendim i PZAP-it Anr. 1/2020, i datës 04.12.2020, më të cilin subjekti politik Lista Serbe është gjobitur me 20,000.00 euro për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore në ditën e votimit në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Mitrovicës së veriut të

mbajtura me 29.11.2021 është vërtetuar me Aktvendimin A.A.nr.13/2020, i datës 08.12.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës,

2. Vendim i PZAP-it Anr. 35/2020, i datës 13.02.2020, lidhur me apelin e parashtruar nga Tinka Kurti, kandidate për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje! (LVV), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 102A-2020 datë 07.02.2020, për shkak të mos dërgimit të emrit të kandidates në fjalë nga KQZ-ja për tu dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës si deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës është vërtetuar me Aktvendimin A.A.nr.4/2020, i datës 19.02.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës,
3. Vendim i PZAP-it Anr. 36/2020, i datës 13.02.2020, lidhur me apelin e parashtruar nga Drita Millaku, kandidate për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje! (LVV), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 102A-2020 datë 07.02.2020, për shkak të mos dërgimit të emrit të kandidates në fjalë nga KQZ-ja për tu dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës si deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës është vërtetuar me Aktvendimin A.A.nr.3/2020, i datës 19.02.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës,
4. Vendim i PZAP-it Anr. 72/2020, i datës 26.10.2020, lidhur me apelin e parashtruar nga subjekti politik Partia Social Demokrate (PSD), kundër vendimit të KQZ-së, me numër protokoll Nr.935-2020 të datës 21.10.2020, për mos ndryshimin e llogos-shenjës së subjektit politik PSD është vërtetuar me Aktvendimin A.A.nr.10/2020, i datës 02.11.2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës.

## **RAPORTI I BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE VJETORE PËR**

### **VITIN FISKAL-2020**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0160. PZAP-i financohet nga Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës.

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2020 përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimit të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e kesh-it (parave te gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€)

Shumat raportuese janë në njësi në €

## **BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE APROVUAR PËR VITIN – 2020**

Me ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-133 për vitin 2020, për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë buxhet në shumë prej 213,116 €.

Planifikimi i buxhetit është bërë në nivel të kategorive ekonomike, përkatësisht të zërave duke respektuar legjislacionin financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik dhe në përputhje me strukturën egzistuese të planit kontabël.

Te kategoria e pagave dhe mëditjeve Buxheti fillestar i aprovuar i PZAP-it ka qenë 135,364€, deri në fund të vitit për këtë kategori nuk ka pasur ndryshime. Ndërsa në fund të vitit janë bërë kursime buxhetore nga Ministria e Financave edhe pse PZAP nuk ka deklaruar kursime të kjo kategori, pra MF ka ndaluar buxhetin e pagave të PZAP-it në shumë prej 2,286.35€, e që buxheti në fund të vitit ka mbetur në shumë prej 133,077.68€. Nga kategoria ekonomike paga dhe mëditje buxheti i PZAP-it në vitin 2020 është shpenzuar në shumë prej 133,077.68€, respektivisht 100%.

Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve Buxheti fillestar i aprovuar ka qenë 69,932€. Me Rishikim të buxhetit me kërkesë të MF, PZAP me 5 qershor 2020 ka deklaruar kursime në shumë prej 10,000€, mirëpo MF ka ndaluar buxhetin në shumë prej 15,000€, gjithashtu edhe në fund të vitit me kërkesë të MF, PZAP-i ka deklaruar kursime edhe 15,000€ të kjo kategori kështu që buxheti i PZAP-it në fund të vitit për kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime ka mbetur në shumë prej 39,932€. Nga kjo kategori buxheti është shpenzuar në shumë prej 20,218.46€. Kjo gjendje për mos shpenzim të buxhetit ka ndodhur ngase të gjithë jemi në dijeni për situatën e pandemisë COVID-19 dhe disa nga aktivitetet që kanë qenë të planifikuara të kryhen nga PZAP-i me buxhetin e

planifikuar për vitin 2020 nuk ka pasur mundësi që ti realizojë, kjo ka qenë arsyeja e mos shpenzimit të mjeteve gjatë vitit 2020 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Te kategoria e shërbimeve komunale, Buxheti fillestar i aprovuar ka qenë 7,820€. Edhe te kjo kategori me Rishikim të buxhetit për vitin 2020 më kërkesë të MF, PZAP me 5 qershor 2020 ka deklaruar kursime në shumë prej 5,000€, mirëpo MF ka ndalur buxhetin në shumë prej 3,877€, gjithashtu edhe në fund të vitit me kërkesë të MF kemi deklaruar kursime edhe 2,829€ të kjo kategori, kështu që buxheti i PZAP-it në fund të vitit për kategorinë shpenzimeve komunale ka mbetur në shumë prej 1,113.19€.

Realizimi i buxhetit të kjo kategori është 375.82€. Nga kjo kategori buxheti është shpenzua në shumë prej 137.03€.

Gjendja e buxhetit të PZAP-it në fund të vitit 2020 ka mbetur në shumën totale prej 174,123€ ku prej tyre në kategorinë e pagave dhe mëditjeve 133,077€, në mallra dhe shërbime 39,932€ dhe në shpenzimet komunale 1,113€.

Në mënyrë të detajuar janë të paraqitura në formë tabelore;


### **Buxheti fillestar i aprovuar dhe buxheti i ndryshuar gjatë vitit 2020**

<b>Kategoritë Ekonomike</b>	<b>Buxheti fillestar i aprovuar 2020</b>	<b>Buxheti i ndryshuar me Rishikim</b>	<b>Buxheti ndryshuar sipas vendimit për kursime në fund të vitit</b>	<b>Buxheti Përfundimtarë 2020</b>
Paga dhe mëditje	135,364	-	(-2,286)	133,077
Mallra dhe shërbime	69,932	(-15,00)	(-15,000)	39,932
Shpenzime Komunale	7,820	(-3,877)	(-2,829)	1,113
<b>Total:</b>	<b>213,116</b>	<b>(-18,877)</b>	<b>(-9,974)</b>	<b>174,123</b>

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it në fund të vitit fiskal në shumë prej 174,123€ si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre :

- 76 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 23 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 6 % për shpenzimet komunale dhe

## Struktura e Buxhetit për vitin - 2020



### **BUXHETI I SHPENZUAR PËR VITIN 2020**

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2020, në përputhshmëri me planin operacional është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it për vitin 2020 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket si në vijim:

**Tabela Buxhetit dhe Shpenzimeve -2020**

<b>Kategoritë Ekonomike</b>	<b>Buxheti fillestar i aprovuar 2020</b>	<b>Buxheti i ndryshuar ne fund te vitit 2020</b>	<b>Buxheti i shpenzuar-2020</b>	<b>Përqindja (%) e buxhetit te shpenzuar Për vitin 2020</b>
Paga dhe mëditje	135,364	133,077	133,078	100%
Mallra dhe shërbime	69,932	39,932	20,218	50.63%
Shërbime Komunale	7,820	1,113	137	12.31%
<b>Total:</b>	<b>213,116</b>	<b>174,122</b>	<b>153,433</b>	<b>88%</b>

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve gjatë vitit janë shpenzuar 100% e buxhetit total të pagave, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti është shpenzuar 50.63% të buxhetit të aprovuar për mallra dhe shërbime, në kategorinë e shërbimeve komunale buxheti u shpenzua 12.31% e buxhetit të aprovuar në këtë kategori.

Gjithsejtë buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2020 në shumë prej 153,433€ apo 88% e buxhetit të aprovuar të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

**Paraqitja grafike sipas kategorive ekonomike**



## Paraqitja grafike e krahasimit te shpenzimeve te vitit 2020 me shpenzimet e vitit 2019




### Paga dhe mëditjet

Te kategoria e pagave dhe mëditjeve Buxheti fillestar i aprovuar ka qenë 135,364€, deri në fund të vitit për këtë kategori nuk ka pasur ndryshime. Ndërsa në fund të vitit janë bërë kursime buxhetore nga Ministria e Financave edhe pse PZAP nuk ka deklaruar kursime të kjo kategori, MF ka ndaluar buxhetin e pagave të PZAP-it në shumë prej 2,286.35€, respektivisht në fund të vitit 2020 buxheti i PZAP-it në këtë kategori ka mbetur në shumë prej 133,077.68€. Nga kjo kategori buxheti është shpenzua në shumë prej 133,077.68€, çka do të thotë se buxheti është shpenzuar 100%.

në €

<b>Kategoritë ekonomike</b>	<b>Shpenzimet -2020</b>
<b>Paga dhe mëditje</b>	<b>133,078</b>
Pagat neto përmes listës se pagave për anëtarët e PZAP-it	43,630
Pagat neto përmes listës se pagave për zyrtarët SPZAP-së	67,119
Tatimi i ndalur në të ardhura personale	9,654
Kontributi pensional i punëtorit	6,337
Kontributi pensional i punëdhënësit	6,337





## Mallra dhe shërbime

Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve, buxheti fillestar i aprovuar ka qenë 69,932€. Me rishikim të buxhetit për vitin 2020 me kërkesë të MF, PZAP me 5 qershor 2020 ka deklaruar kursime në shumë prej 10,000€, mirëpo MF ka ndalur buxhetin në shumë prej 15,000€, gjithashtu edhe në fund të vitit me kërkesë të MF, PZAP ka deklaruar edhe 15,000€ të kjo kategori kështu që buxheti në fund të vitit për kategorinë mallra dhe shërbime ka mbetur në shumë prej 39,932€. Nga kjo kategori buxheti është shpenzua në shumë prej 20,218.46€. Të gjithë jemi në dijeni për situatën e pandemisë COVID-19 dhe disa nga aktivitetet që kanë qenë të planifikuara të kryhen nga PZAP-i me buxhetin e planifikuar për vitin 2020 nuk ka pasur mundësi që ti shfrytëzojë, kjo ka qenë arsyeja e mos shpenzimit të mjeteve gjatë vitit 2020 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxheti është shpenzua 51%.

Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:

- Modullit të aprovimeve dhe
- Modullit të blerjeve-prokurimit.

Me poshtë janë të prezantuara në formë tabelore shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2020.

## Shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet sipas nën kodeve ekonomike

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2020
<b>Mallra dhe Shërbime</b>	<b>20,218</b>
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	6.00
Shpenzimet për internet	646.80
Shërbimet tjera telefonike vala 900	6,615.00
Shërbimet postare	16.50
Furnizim me ushqim dhe pije –jo dreka zyrt.-uji	224.30
Furnizimi për Zyre	2,122.05
Shpenzimet për karburant për vetura	418.72
Regjistrimi i automjeteve	170.00
Sigurimi i ndërtesave	970.49
Taks komunale për regjistrim te automjet. Zyrtar	20.00
Sigurimi i ndërtesave tjera	240.00
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	396.00
Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve	110.00
Qiraja e pajisjeve	186.93
Harduer për teknologji informative(me pak se 1000 euro)	7,123.70
Drekat zyrtare	852.00


## Paraqitja grafike e shpenzimeve ne kategorinë mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike



## PJESA PËRMBYLLSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE

Në bazë të të dhënave të SIMFK dhe data bazës të Sekretariatit të PZAP-it mund të përfundojmë se për vitin 2020, Buxheti është shpenzuar në shumë prej **153,433€**. Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2020.

### Paraqitja grafike e buxhetit te planifikuar dhe shpenzuara të PZAP-it për vitin 2020



## TË HYRAT E PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) në bazë të nenit 120 paragrafi 1. pika c. të Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 mund të shqiptoj gjoba ndaj një Subjekti Politik në rast se përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së.

Gjatë vitit 2020, PZAP ka shqiptuar gjoba në shumë prej 20,000 euro për partinë politike Lista Serbe gjatë zgjedhjeve për Kryetar në Komunën e Mitrovicës Veriore, që janë mbajtur më 29 nëntor 2020 dhe ky borxh në shumë prej 20,000 euro është realizuar në muajin dhjetor të vitit 2020.

PZAP pothuajse në tërësi i ka realizuar gjokat që u janë shqiptuar subjekteve politike.

Vetëm subjekti Politik Koalicioni Sloboda, ende nuk e ka paguar borxhin në shumë prej 5,100 euro, ku kjo gjobë është shqiptuar në vitin 2019 pra edhe në tabelën më lart e kemi paraqitur si borxh të vitit 2019.

Gjithsejtë borxhe të pa paguara kanë mbetur edhe **5,100€**.

Për detaje e kemi përgatitur tabelën me të dhëna të detajuara.

Nr.	Vendimi i PZAP-it	Emri i subjektit politik	Data e marrjes së vendimit	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
	Anr.156/2019	Koalicioni "Sloboda"	04.10.2019	5,100		5,100
	<b>Totali</b>			<b>5,100</b>	<b>-</b>	<b>5,100</b>

#### TE HYRAT E REALIZUARA GJAT VITIT 2020

Nr.	Nr. i vendimit te PZAP	Subjekti politik	Përshkrimi i te hyrave	Pagesa e gjobës	Data e pagesës se borxhit
1	Anr.1096/2017	Alternativa	Pagesa e gjobës në bazë te vendimit Anr, 1096/2017 te Zgjedhjeve Lokale - 2017	1,200	14.01.2020
2	Anr.148/2019	IRDK	Pagesa e gjobës në bazë te vendimit Anr, 148/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës	1,200	14.01.2020
3	Anr.233/2019, 238/2019,287/2019	LVV	Pagesa e gjobës në bazë te vendimit Anr, 233/2019, 238/2019, 287/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës	14,100	28.01.2020
4	Anr.197/2019	KDTP	Pagesa e gjobës në bazë te vendimit Anr, 197/2019 për Zgjedhjet	1,100	28.01.2020

			e Parakohshme për Kuvend të Kosovës		
5	Anr. 166, 167, 168, 177, 216,264/2019	NISMA-AKR-PD	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit Anr, 166, 167, 168, 177, 216,264/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës	33,900	30.01.2020
6	Anr.107/2019	PREBK	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit Anr, 107/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës	250	30.01.2020
7	Anr.97, dhe 328/2019	AAK	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit Anr, 97 DHE 328/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës	7,500	03.02.2020
8	Anr. 103, 125, 133, 139, 194/2019	PDK	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit Anr, 103, 125, 133, 139, 194/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës	23,700	11.02.2020
9	Anr.-Paguar në bazë të vendimeve të shqiptuara gjatë vitit 2019- të ndalura nga KQZ	LDK	Pagesa e gjobës në bazë të vendimeve të shqiptuara gjatë vitit/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të ndalura nga KQZ	74,850	14.02.2020
10	Anr.-Paguar në bazë të vendimeve të shqiptuara gjatë vitit 2019- të ndalura nga KQZ	PDK	Pagesa e gjobës në bazë të vendimeve të shqiptuara gjatë vitit/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të ndalura nga KQZ	31,400	14.02.2020
11	Anr.-Paguar në bazë të vendimeve të shqiptuara	VAKAT	Pagesa e gjobës në bazë të vendimeve të shqiptuara gjate	1,100	14.02.2020

	gjatë vitit 2019- të ndalura nga KQZ		vitit/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të ndalura nga KQZ		
12	Anr.-Paguat në bazë të vendimeve të shqiptuara gjatë vitit 2019- të ndalura nga KQZ	AAK-PSD	Pagesa e gjobës në bazë të vendimeve të shqiptuara gjatë vitit/2019 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të ndalura nga KQZ	82,100	08.04.2020
13	Anr.1096/2017	Alternativa	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit Anr, 1096/2017 të Zgjedhjeve Lokale - 2017-pagesa me këste e fundit	1,500	27.10.2020
14	Arn.01/2020	Lista Serbe	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit Anr, 01/2020 të Zgjedhjeve për kryetar komune në Podujevë dhe Mitrovicë te Veriut	20,000	14.12.2020
		<b>Total:</b>	<b>293,900</b>		

Gjatë vitit 2020 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 293,900€, ku ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

## **NJËSIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE LOGJISTIKËS**

Gjatë periudhës janar-dhjetor – 2020, njësia e TI dhe Logjistikes ka pasur disa aktivitete:

Njësia e Teknologjisë Informative ka bërë planifikimin, administrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e TI-së dhe aplikacioneve të Microsoft të ofruar nga Ministria e Administratës Publike, si dhe mirëmbajtjen dhe administrimin e Ueb faqës dhe Sistemit për Menaxhimin e Rasteve, domeni-it (rrjetin e brendshëm).

Në funksion të përmbushjes së detyrave që ndërlidhen me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e çështjeve nga teknologjia informative, janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme sipas kërkesave të zyrtarëve. Në kuadër të aktiviteteve më kryesore nga kjo njësi, është mirëmbajtja dhe azhurnimi

në vazhdimësi i Ueb faqes së PZAP-it dhe rrjeteve sociale, ku gjatë kësaj periudhe vjetore janë publikuar të gjitha vendimet gjatë Procesit Zgjedhor, formularë, udhëzime, raporti vjetor i punës-2019 dhe informacione tjera që kanë qenë të dobishme për Institucionin. Në vazhdimësi bëhet ofrimi i përkrahjes teknike në Sistemin për Menaxhimin e Rasteve dhe Teknologjisë Informative. Aktivitete tjera nga kjo njësi ka pasur edhe nga fusha të tjera si logjistike ku është bërë regjistrimi i inventarit në sistemin E-Pasuria dhe SIMFK, janë përgatitur specifikat për furnizime sipas kërkesave të njësive përkatëse, furnizim me inventar për zyre, pajisje të teknologjisë informative, sigurimin e automjeteve zyrtare, tërheqja e parave të imta dhe përcjellja e shpenzimit me para të imta, zotimi i mjeteve financiare për çdo shpenzim të ndodhur si dhe punë tjera sipas kërkesave të menaxhmentit dhe zyrtarëve të PZAP-së.

Identifikimi i nevojave të PZAP-it për softuer të licencuar për vitin 2020. Aktivitete tjera nga kjo njësi ka pasur me inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve të PZAP-it përmes programit E-pasuria, ku në këtë lëmi kemi pasur aktivitete të vlerësimit dhe ri-vlerësimit të pajisjeve nga teknologjia informative. Duke u bazuar në Rregulloren MF – NR. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare, kemi të drejtë që të bëjmë rivlerësimin e pasurisë, pasi ato janë funksionale dhe në gjendje të rregullt.

## **NJËSIA E PËRKTHIMEVE**

Koordinatori për përkthim ka kryer të gjitha obligimet e dalura nga PZAP/SPZAP, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Nga njësia e përkthimeve gjatë 2020 janë kryer disa aktivitete që i përkasin këtyre njësive. Nga njësia e përkthimeve janë përkthyer të gjitha dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të Panelit dhe zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it si: përkthimi i Raportit Vjetor të punës-2019; Planit të Punës-2020, përkthimi i agjendave dhe procesverbaleve të takimeve të PZAP-it dhe të Sekretariatit të PZAP-it, si dhe dokumenteve të tjera sipas kërkesës së zyrtarëve.

Nga njësia e të hyrave është bërë pranimi i të hyrave në sistemin e Free Bilancit sipas kërkesave të Departamentit të Thesarit që ka pasur të hyra në llogarinë e PZAP-it.

Nga pranimi i mallit në depo janë bërë të gjitha pranimet e nevojshme që duhet të kryhen rregullisht në bazë të procesit të realizimit të pagesave. Përpos këtyre aktiviteteve, në vazhdimësi janë kryer edhe aktivitete tjera si: kontrollimi i inventarit në depo ku për ç’do fund vit bëhet regjistrimi i të

gjithë inventarit dhe i materialit administrativ që është në depo dhe inventarit që kemi në posedim, ngarkimi i zyrtarëve me material administrativ, ngarkimi dhe shkarkimi i depos, si dhe detyra tjera sipas kërkesave të zyrtarëve.

## **NJËSIA E TRANSPORTIT**

Nga njësia e transportit gjatë vitit 2020 janë kryer të gjitha shërbimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me transport si: mbajtja e evidencave të qarkullimit të veturave zyrtare dhe evidentimi i ç’do kilometër të kaluar gjatë qarkullimit të automjeteve. Në vazhdimësi janë raportuar në mënyrë specifike për ç’do muaj edhe në formë tabelave për shpenzimet e litarëve të shpenzuara për derivate, si dhe kilometrat e kaluara për veturë zyrtare.

### **Të dhënat për kilometrat e kaluara dhe litrat e harxhuara për janar-dhjetor 2020 për veturat FORD dhe MITSUBISHI**

<b>Vetura</b>	<b>KM janar-mars-2020</b>	<b>Litrat e harxh. janar-mars-2020</b>	<b>KM prill-qershor-2020</b>	<b>Litrat e harxh. prill-qershor-2020</b>	<b>KM korrik-shtator-2020</b>	<b>Litrat e harxh. korrik-shtator-2020</b>	<b>KM tetor-dhjetor 2020</b>	<b>Litrat e harxh. tetor-dhjetor 2020</b>	<b>KM janar-dhjetor 2020</b>	<b>Litrat e harxh. janar-dhjetor 2020</b>
<b>Ford</b>	596	47	486	40	519	45	826	45	<b>2,427</b>	<b>117</b>
<b>Mitsubishi</b>	265	0	269	0	8	0	34	28	<b>649</b>	<b>28</b>

Gjatë vitit 2020 për veturën zyrtare FORD janë shpenzuar 117 litra karburante dhe 2,427 kilometra të kaluara .

Ndërsa, për veturën zyrtare MITSUBISHI për vitin 2020 janë të shpenzuara 28 litra karburante dhe kilometra të kaluara janë 649 km.

Përpos këtyre aktiviteteve nga njësia e transportit janë kryer edhe punë tjera si: përcjellje e vazhdueshme e veturave për ndonjë defekt eventual dhe dërgimi për servisim, si dhe është bërë servisimi i rregullt i veturave, pranimi i faturave për derivate dhe për servisim të automjeteve, pastrimi i veturave sipas nevojës, shërbimet me transport sipas kërkesave të Kryesueses/ kryesuesit anëtarëve të Panelit si dhe zyrtarëve të SPZAP-it, shpërndarja e dokumenteve të ndryshme nëpër Institucione si dhe punë të tjera.